



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

Numri i lëndës: 2020:140820

Datë: 13.05.2024

Numri i dokumentit: 05677087

**C.nr.510/2020**

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË – Departamenti i përgjithshëm – Divizioni civil, me gjyqtar Robert Tunaj , dhe procesmbajtës F. Kabashi në çështjen juridiko - kontestimore të paditësve, K.S dhe S, të cilin e përfaqëson av.S. H , kundër të paditurit B. Xh. S nga S ,për vërtetim të pronësisë, me datë 13.05.2024, mori dhe përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

Në bazë të pohimit

**I. APROVOHET në tërësi** kërkesëpadia e paditësit K. S nga S

**II. VËRTETOHET** se paditësi K. S, është pronar me 1/1 i ngastrës kadastrale nr. P-72116043-00721-21, ZK Sopijë , në sipërfaqe prej 1200 m2.

**III. DETYROHET** i padituri B. S, që paditësit t’ia njohin të drejtën e pronësisë në ngastrën kadastrale nr. . P-72116043-00721-21, ZK Sopijë , në sipërfaqe prej 1200 m2.

**V.** Ky aktgjykim do t’i shërben paditësit si titull juridik për të bërë ndryshimin e pronësisë në regjistrin për regjistrimin e të drejtave të paluajtshmerive, i cili mbahet në Drejtorinë për Shërbime Pronësore – Juridike dhe Kadastër,

**V.** Se cila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

**A r s y e t i m**

Paditësi K. S nga S , pranë kësaj gjykate kanë parashtruar padi kundër të paditurit B. S, për shkak të vërtetimit të së drejtës së pronësisë mbi bazën e mbajtjes me mirëbesim për me shumë se 20 vite pa ndërprerë.

Në seancën e shqyrtimit kryesorë paditësit në tersi ka ngelur pranë padisë dhe kërkesëpadisë, me propozim që gjykata të njëjtën ta aprovoi dhe të nxjerrë aktgjykim në bazë të pohimit.

I paditurit B. S, ka deklaruar se nuk e kundërshtojnë kërkesëpadinë e paditësve dhe se të njëjtën e pohojnë në tërësi si të bazuar, duke shuar se paditësi është në posedim faktik të pandërprerë të së njëjtës dhe se paraardhësi i tyre e ka shitur para më shumë se 20 vite dhe i ka propozuar gjykatës që padinë e paditësve ta aprovoj si të bazuar dhe gjykata të sjell aktgjykim në baze të pohimit.

Gjykata në kuptim të nenit 7 dhe 8 bëri shikimin e provave dhe atë: në certifikatën e pronës nr.3839/2020 të dt.22.10.2020, për parcelën kadastrale . P-72116043-00721-21, ZK Sopijë , në sipërfaqe prej 1200 m2.

Ka dëgjuar në cilësi të palës të paditurin.

Gjykata pas leximit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, deklaratës së të paditurit të dhëna në këtë procedurë, vendosi që të aprovon në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit , pasi që i padituri në seancë gjyqësore në tërësi e kanë pohuar kërkesëpadinë e paditësve.

Nga dëgjimi i palëve me pa mëdyshje ka vërtetuar faktin se paditësit me mirëbesim e kanë më tepër se 20 vite në posedim të pa ndërprere palujtshmerin objekt kontesti andaj në këtë drejtim edhe mbi bazën e fitimit me parashkrim ne kuptim të nenit 40 par. 1 te Ligjit për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore kanë fituar të drejtën e pronësisë mbi sendin.

Gjykata hoqi dyshimet që kanë të bëjnë me kërkesat e palëve të cilët nuk mund të disponojnë lirisht neni 3.3 të LPK-së.

Me nenin 148 par.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), është paraparë se *“Në qoftë se i padituri deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor të çështjes e pohon kërkesëpadinë pjesërisht apo tërësisht, gjykata jep pa shqyrtim të mëtejshëm, aktgjykimin me të cilin e aprovon pjesën apo gjithë kërkesëpadinë (aktgjykim në bazë të pohimit)”*.

Andaj duke u bazuar në nenin 148 par.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet ligjore për dhënien e këtij aktgjykimi.

Vendimin mbi shpenzimet gjykata e mori duke u bazuar në nenin 450 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL  
2020:140821 data,13.05.2024**

## **G j y q t a r i**

**Robert Tunaj**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate.